



# 2K Fusion

## Gjysëm mat

IZOLIMI



Vernik parketi 2 komponentësh me bazë uji. Për dëmtime ekstreme. Elasticitet, rezistencë e shkëlqyer ndaj kimikateve dhe friksionit.

- Përpunimi i shpejtë dhe i sigurt
- Rezistencë e shkëlqyer ndaj dëmtimeve
- Raport i mirë kosto/performancë
- Cilësi jorrëshqitëse të certifikuar për ambiente pune DIN EN 16165:2021-12
- Meets all requirements of ÖNORM C2354:2009 for the highest stress class


### Gama e përdorimit:

Të përshtatshme për dysheme druri, parkete dhe dysheme tape. Rezistencë ndaj rrëshqitjes sipas grupit të vlerësimit R9 DIN EN 16165:2021-12.



## Të dhëna teknike të produkteve

### Ngarkesa



NR. ARTIKULLI



11471

5 kg

2

96

Niveli i shkëlqimit përafërsisht\* 33

Solide 36 ±2%

Viskoziteti 25 ±2s

Magazinimi dhe transportimi 12 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit.

Material i parrezikshëm sipas ADR. Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C. Mbrojeni nga ngrica.

GISCODE W3/DD+

2004/42/CE

Vlera e lejueshme i BE-së për produktin (Kat. A/j): 140g/l (2010). Ky produkt përmban maksimumi 68g/l VOC (Përzjerje me përforsues).

\*Shkalla e shkëlqimit matet në temperaturë 60° në qelq. Varet nga trashësia e shtresës dhe kushtet e ambientit (temperatura, lagështira relative e ajrit) gjatë tharjes. Vlerat janë vetëm indikative.

## Udhëzime përpunimi

- Tundeni mirë produktin, shtoni përforsues në raport 10:1 dhe përzieni duke tundur. Në rast përzierje sasive të vogla përdorni matësin e sasive LOBA ose një shkallë tjetër matje të përbërësve. Pas përzierjes përpunimi mund të bëhet deri në 2 orë.
- Sipërfaqja duhet të jetë lëmuar siç duhet. Dyshemeja duhet të jetë e thatë, pa shtresa të vjetra, vaj, yndyra, dyll, silikon, pluhur lëmimi dhe papastërti të tjera.
- Kushtet optimale të përpunimit eksitojnë në një temperaturë mjedisi nga +15°C deri + 25°C, temperaturë dyshemeje +15°C deri +22°C, lagështirë relative të ajrit 40% - 75%, temperaturë të materialit +18°C - + 25°C, lagështirë maksimale të drurit 12%, ajrosini mjaftueshëm mjediset e punës.
- Për të parandaluar dëmtimet e parketit duhet që gjatë përpunimit të synohet klima e pritshme e mjedisit që pritet në mesin e vitit.
- Për të reduktuar rrezikun e presionit të tepërt të ënjtjes, rekomandojmë aplikimin e maksimumit 2 aplikime me rul në ditë.
- Para aplikimit transferoni materialin në një kovë LOBATOOL.
- Tundni mirë materialin.
- Ky produkti është pjesë integrale e "Connected Systems" të LOBA dhe Wakol. Kombinimet e miratuara me materialet ngjitëse të parketit Wakol i gjeni në "Connected Systems Matrix": [www.loba.de/connected-systems](http://www.loba.de/connected-systems)
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në [www.wingis-online.de](http://www.wingis-online.de).

### HOLLUES

Produkti është gati për përpunim dhe nuk lejohet hollimi!

### MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

Rulon me llak LOBA Deluxe 120 dhe rulon me llak LOBA Microfaser 100-120 / 100-120 ml(g)/m<sup>2</sup> = 8-10m<sup>2</sup>/l(kg)

### RRASHINIM I NDËRMJETËM

Brënda 24 orëve mund të bëhet lyerje me astar pa rrashinim të ndërmjetëm në vijim. Rezultati përfundimtar vizual mund të përmirësohet me një lëmim të ndërmjetëm përpara shtresës së fundit të bojës.

Përdorni Pad LOBASAND Lochpad P120 me vrima ose më të hollë, alternativisht copë lëmuese LOBASAND Schleifgitter P120 ose më të hollë.

Para lyerjes me vernik largoni plotësisht pluhurin.

### KOHA E THARJES

- Mund të ecet mbi të me kujdes, mund të shtrohet me rërë dhe mund të verniçohet mbi të jo më herët sesa pas 4 orësh.
- Përdorim i lehtë pas 24 orëve.
- Mundësi përdorimi të plotë dhe mbulimi pas 5 ditësh.
- Mbulimi i shpejtë mundosohet me LOBA Cover 400, për detaje shih informacionet teknike të produktit.
- Koha e tharjes e përmëndur është e vlefshme për temperaturë +20°C dhe lagështi relative të ajrit 50%.

### REKOMANDOHET PËRDORIMI I ASTARIT:

Për minimizimin e ngjitjes së cepave, grumbullimin dhe bllokimin e elementeve përbërëse të drurit p.sh. drurë ekzotike.

- EasyPrime.
- 2K Intensive
- VivaPrime.
- PrimaSeal Plus (me bazë tretës).

### Additives

The range of application, properties and appearance can be extended by combining with LOBA additives. Please refer to the technical information of the additives for possible combinations.

### PËRDORIMI NË PARKETE DHE DYSHEME DRURI:

- Përgatisni përshtatshëm dhe aplikoni astarin të nënshtresa.
- Tharje e astarit siç parashikohet.
- Aplikoni vernik me rulon.
- Tharje.
- Rrashinim i ndërmjetshëm.
- Aplikoni me rulon shtresën e dytë të vernikut.

### PËRDORIM NË TAPË:

Hermetizoni pasi ngjitësi të jetë mpiksur mjaftueshëm.

#### Tapë natyrale e papërpunuar:

- Aplikoni me rulon tre shtresa verniku.
- Pas shtresës së parë, lini një natë të thahet (dedukton rrezikun për bymim të kokkrizave).
- Lëmim i ndërmjetëm para shtresës së fundit.

#### Tapë e pararegatitur në fabrikë

Merrni parasysh udhëzimet e furnitorit të tapës. Nëse është i përshtatshëm për lyerje me vernik pas lëmimit të ndërmjetëm aplikoni me rulon një apo dy shtresa verniku.

#### Rinovim / Rilyerje me vernik mbi shtresat e vjetra

Pastrim i nënshtresës me LOBA CareRemover. Përdorni aparat me disk tek dhe LOBASAND SpecialPad jeshil. Mbetjet nga përpunimi duhet të hiqen plotësisht. Edhe pak mbetje të lëna mund të ndikojnë negativisht aderimin e vernikut. Pastroni me ujë të pastër. Pas tharjes kryhet lëmim i plotë i ndërmjetëm. Aplikoni me rulon një ose dy shtresa verniku.

## Udhëzime përpunimi

### Këshilla mbi dhënien e ngjyrës

Për arritjen e një ndriçimi/ një efekti zbardhues në nënshtresa të ndriçuara ne këshillojmë shtimin e LOBA Whitener në përputhje me IT (informacionet teknike) mbi produktin. Për të minimizuar reaksionet e ngjyrës me tandinën, në rastin e materialit të tapave duhet që shtresa e parë e llakut të aplikohet në formën e lëvruar

pa shtesë për ngjyrën. Më pas është e domosdoshme që të kryhet tharja gjatë natës.

Për arritjen e një intensifikimi të ngjyrës mbi materialin natyror të tapave si dhe dyshemetë prej tape të ngjyrosura me ngjyrë të murrme dhe të kuqërremtë, ne këshillojmë shtimin e LOBA Amberizer në përputhje me IT mbi produktin.

## Udhëzime të përgjithshme

**Pastrimi i mjeteve të punës:** Pastroni mjetet e punës me ujë menjëherë pas përdorimit.

**Koha e tharjes:** Koha e tharjes e përmëndur është e vlefshme për temperaturë +20°C dhe lagështi relative të ajrit 50%, si dhe ajrosje të vazhdueshme të ambientit të punës, pa rryma ajri. Temperaturat më të ulta, lagështia relative e lartë, mosajrosja e duhur vonojnë tharjen. Pa arritur forcimin (tharjen) e plotë mos pastroni dhe mos shtroni tapete. Për mbulimin e sipërfaqes para tharjes së plotë përdorni LOBA Cover 400. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

**Rrashinim i ndërmjetëm:** Në rastin e aplikimit të disa shtresave verniku, për arritjen e aderimit të mjaftueshëm të shtresës së ndërmjetme, lysterja e shtresës që pason bëhet brënda 24 orëve pa rrashinim të ndërmjetëm. Me rrashinim të ndërmjetëm para aplikimit të shtresës së fundit arrihet një sipërfaqe e njëtrajtshme. Pastroni me kujdes pluhurin pas çdo rrashinim të ndërmjetëm.

**Përdorim i astarit apo punim vetëm me vernik:** Përdorimi i astarit rrit sigurinë e përpunimit dhe garanton një sipërfaqe pa shenja dhe vijëzime, pothuajse në çdo rast pavarësisht llojit të drurit. Më shumë detaje gjenden në listën me llojet e drurit LOBA te katalogu në fjalë.

**Ngjitje e anëve:** Sistemet e bojrave me bazë ujin në përgjithësi kanë tendencë për ngjitje të cepave. Për të reduktuar formimin e lidhjeve të parregullta dhe ngjitjen e mëvonshme të elementeve këshillohet marrja e masave paraprake si: ngjitje e qëndrueshme elastike ose kundër shtytëse e elementeve të parketit, mbushje të kujdesshme e fugave me stuko, përdorim i astarëve të përshtatshëm si p.sh. LOBA EasyPrime, trajtimi paraprak i anëve të zbrazta të parketeve prej druri solid me dyll të përputhshëm me bojën, para instalimit. Po ashtu, marrja e masave të cilat do ruajnë një klimë të qëndrueshme në dhomë dhe veçanërisht lagështinë relative të ajrit. (Rekomandohet informimi me kujdes i klientit). Veçanërisht të ndjeshme janë dyshemetë e vjetra të dëmtuara ose të paqëndrueshme, parketet prej druri me ngjitje elastike ose të gozhuara, parketet me dërrasa druri, dyshemetë me veshje druri, parketet laminate, parketet mbi dysheme me system ngrohje, drurët me kohë të shkurtër ndryshimi të lagështirës si ah, panja.

**Ndërveprime:** Materiale të tilla si p.sh. nënshtresat e tapeteve, këmbët dhe rrotat e mobiljeve, ngjitësat elastikë për ngjitje ose fiksime të parketeve mund të shkaktojnë zbutje dhe çngjyrosje. Materiale ndërtimi të lëna mbi lidhjet mund të ndikojnë negativisht në prekje dhe në pamje. Ekspozimi në bojra floku, goma makinash, motorash, biçikletash, gjithashtu mund të shkaktojë çngjyrosje të përhershme dhe të pandryshueshme të sipërfaqes.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvijës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speciale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia jonë përcaktohet ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

**Connected Systems:** Nëpërmjet Connected Systems, produktet e testuara janë të optimizuara në mënyrë të tillë që të mos ketë ngjyrosje të errët të shkaktuar nga ndërveprimi kimik midis llakut dhe ngjitësit në rastin e përpunimit profesional.

Fjalët dhe simbolet me shenjen © përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.